



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 10.6.2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavleviq, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Blerim Shala, Suzan Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj, Ismet Beqiri dhe Alma Lama.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të datës 20.5.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të datës 20.5.2013;

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-149, për ekzekutimin e sanksioneve penale, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, rregullon procedurat e ekzekutimit të sanksioneve penale, sanksionet për kundërvajtje, masat e trajtimit të detyrueshëm, aplikimin e masës së paraburgimit si dhe organizimin e brendshëm të organeve që merren me ekzekutimin e këtyre sanksioneve.

Pas shqyrtimit dhe pasi që është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk mbulohet me legjislacionin e BE-së, si rezultat i kësaj nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Vjosa Osmani: “U tha që nuk e rregullon legjislacioni i BE-së, në fakt është një Konventë e Hagës, e cila ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja, që do të thotë që një pjesë të këtij ligji e mbulon legjislacioni i BE-së. Mirëpo, mundemi atë plotësim ta bëjmë më vonë. Është ajo konventë, të cilën e aplikon në çdo rast Gjykata Evropiane e Drejtësisë, e cila është pjesë e BE-së”.

Kryetari, theksoi se në këtë Konventë nuk është thirrur as Qeveria, andaj konsiderojmë që nuk ka nevojë të ndërhyjmë.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. . 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

5. Të ndryshme.

a) Njoftim rreth ftesës së Senatit Çek për Komisionin

Kryetari, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Senati Çek, i ka dërguar një ftesë Komisionit, për vizitë zyrtare në Çeki. Po ashtu, njoftoi se kjo vizitë ka qenë e planifikuar vitin e kaluar, ku sipas Kryesisë, është dashur që të udhëtojnë nënkryetarët dhe kryetari i Komisionit. Tani tha, duhet që të procedohet me kërkesë për Kryesi. Vizita parashihet të bëhet, prej datës 17 deri më 19 qershor 2013.

b) Vizita e kryetarit të Komisionit për çështje evropiane të Turqisë

Kryetari, i njoftoi se në muajin qershor, me ftesë të Komisionit për Integritet Evropian, ka qenë e planifikuar vizita e Kryetarit të Komisionit për çështje evropiane të Turqisë. Mirëpo, për shkaqe shëndetësore të Kryetarit të Komisionit për Çështje Evropiane të Turqisë, kjo vizitë është shtyrë për ndonjë datë tjetër.

d)Kërkesë për koordinimin e punës së grupit punues

Vjosa Osmani, tha se është esenciale që grupet punuese të kenë në përbërje edhe pozitën edhe opozitën, pasi që është mirë që raporti që del nga ky Komision, të votohet unanimisht në Komision, para se të shkojë në seancë. Ajo shtoi se deri më sot, për çdo takim që është realizuar, paraprakisht jemi konsultuar ne si anëtarë, e pastaj janë caktuar vizitat. Mirëpo, vizita që është organizuar në Mitrovicë, së paku neve të opozitës, nuk na kanë konsultuar lidhur me kohën dhe vetëm është caktuar një ditë. Unë kam kërkuar që të ndërrohet dita. Në fillim më është thënë që do të ndërrohet data, mirëpo, siç e pash, ajo vizitë ishte realizuar. Andaj, tha është mirë që sekretariati i Komisionit, para se të realizojë vizitën, të na konsultojë edhe neve, nëse ajo ditë na përshtatet ose jo.

Suzan Novoberdali: “E mbështes deputeten Osmani, sepse edhe unë kam të njëjtin shqetësim sepse jam njoftuar shumë vonë për atë takim dhe përkundër interesimit tim, për të marr pjesë në atë takim nuk kam arritur që të jem atje, për shkak të angazhimeve të tjera që kisha”.

Blerta Deliu-Kodra: “ Po flas në cilësinë e kryetares së Grupit Punues. Tri javë kemi bërë përpjekje që të aranzhojmë atë takim. Në këtë rast, ja jep fjalën mbështetësit të Komisionit, sepse këta kanë qenë ata, të cilët i kanë aranzhuar datat dhe takimet dhe ka qenë e pamundur që të mblidhet një numër i deputetëve. Në kemi shkuar në takim informues dhe kemi vendosur që brenda kësaj jave të caktojmë një takim dhe të shkojmë së bashku si komision, që të bëjmë monitorimin e këtij ligji.

Kryetari, tha se mundësisht duhet të koordinohemi dhe të shkojmë së bashku si Komision dhe propozoi që vizita të realizohet ditën e mërkurë.

Vjosa Osmani, duke marrë fjalën tha se më duket më esenciale që të jetë prezent Komisioni në përbërje të plotë, sesa Kryetari i Komunës. Ajo shtoi, se është Kryetari i Komunës, ai që nuk po gjen kohë për t’u takuar. Më esenciale është që të jenë deputetët e Kuvendit, sepse ne po shkojmë të shohim se si janë kushtet e ripranimit sepse për atë se çka thotë kryetari i Komunës, ne mund të kërkojmë vetëm raport më shkrim nga ana e tij.

Kryetari **Lufi Haziri,** theksoi se pajtohem që vizita në Mitrovicë të realizohet ditën e mërkurë, me datën 12 qershor 2013, në orën 11:00. Për detajet e tjera, do të njoftoheni me kohë, pas konfirmimit të takimit edhe nga ana e kryetarit të Komunës së Mitrovicës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Lufi HAZIRI